

E drejta për informim

Newsletter mujor mbi mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për të Drejtën e Informimit

Newsletter është publikim i Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Fokusi i muajit

Autoriteti Publik

Zbatimit të Ligjit nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit" i nënshtrohen autoritetet publike, të cilat sipas përkufizimit janë të klasifikuara në tre kategori.

Kategoria e parë përfshin çdo organ administrativ të parashikuar në legjislacionin në fuqi për procedurat administrative si dhe organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësisve të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj.

Kategoria e dytë e autoriteteve publike janë shoqëritë tregtare ku: i) shteti zotëron shumicën e aksioneve ii) ushtrohen funksione publike nga çdo person fizik ose juridik, të cilit i është dhënë me ligj, akt nënligjor ose çdo lloj forme tjetër, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, e drejta e ushtrimit të funksioneve publike.

Kategoria e tretë e autoriteteve publike përcakton çdo person fizik ose juridik, të cilit i është dhënë me ligj, akt nënligjor ose çdo lloj forme tjetër, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, e drejta e ushtrimit të funksioneve publike.

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka publikuar në faqen e saj zyrtare Udhëzuesin "Autoritetet publike në zbatim të Ligjit për të Drejtën e Informimit" të cilin e gjeni për konsultim në https://www.idp.al/wp-content/uploads/2017/02/Udhezues_kush_eshte_AP.pdf Në këtë udhëzim bëhet një analizë e detajuar e koncepteve të autoritetit publik, organit dhe institucionit si dhe interpretim të doktrinës legjislative dhe gjyqësore për të përcaktuar nëse me termin Autoritet Publik do të konsiderohet organi qendror përfshirë degët e tij rajonale apo nëse këto të fundit do të konsiderohen autoritet publik më vete.

Përmbledhje mujore e vendimeve

Vendim Nr. 41 - Shoqëritë që kryejnë funksione publike sipas një akti ligjor apo nënligjor janë subjekt i LDI

Vendim Nr. 42 - Shoqëritë ku shteti nuk është aksioner shumice dhe nuk kryejnë funksione publike sipas një akti ligjor apo nënligjor, nuk janë subjekt i LDI

Vendim Nr. 43 - Autoriteti Publik tregon në përgjigje pjesën e informacionit të refuzuar

Vendim Nr. 44 - Informacioni i cili pas procedurës së rishikimit mbetet i klasifikuar, kufizohet

Vendim Nr. 45 - Tabela e vlerësimit të dosjes së kandidatit fitues është informacion publik

Vendim Nr. 46 - Informacioni për personat publik zyrtarë nëpërmjet të cilit pasqyrohet aktiviteti publik, administrativ ose çështje lidhur me detyrën e tyre është informacion publik

Vendim Nr. 48 - Kufizimi i informacionit vlen për aq kohë sa qëndron arsyeja e kufizimit

Vendimarrja e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMDP), gjatë muajit tetor, ka dhënë 7 vendime në zbatim të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" (LDI). 5 vendime kanë qenë vendime urdhërimi ndaj autoriteteve publike për të dhënë informacionin e kërkuar dhe 2 vendime rrëzimi ndaj ankesave të paraqitura.

Gjatë shqyrtimit të ankesave të qytetarëve dhe ndjekjes së procedurave administrative KDIMDP ka vërejtur se përkufizimi i Autoritetit Publik ndaj të cilit njih zbatim Ligji nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit" nuk është ende i qartë si nga ana e vetë autoriteteve publike ashtu dhe nga ana e qytetarëve. Pikërisht evidentimi i rasteve kur kemi të bëjmë me aplikimin e përkufizimit mbi "Autoritetin Publik" ka qenë në qendër të 2 vendimeve të fundit të dhëna nga ana e KDIMDP.

Me anë të Vendimit nr. 41 datë 05.10.2020 Zyra e Komisionerit ka pranuar ankesën e gazetarit E.H i cili i kërkonte Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH) dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (MIE) informacion dhe dokumentacion të vlerësimit të kryer nga grupi ndërinstitucional i ngritur në zbatim të V.K.M. nr. 234, datë 17.4.2019 "Për Programin e Integruar të Zhvillimit "Poli i Drejtësisë" për godinën e ndërtuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë.

FSHZH refuzonte dhënien e informacionin ku ndër të tjera arsyetonte se ky institucion funksionon në përputhje me ligjin nr. 10 130, datë 11.05.2009, "Për Fondin Shqiptar të Zhvillimit" i ndryshuar. Bazuar në pikën 1 dhe 2 të nenit 4 të këtij ligji, FSHZH-është person juridik dhe gëzon statusin e organizatës jofitimprurëse, gëzon pavarësi drejtuese, administrative, financiare dhe teknike. Përsa më sipër rezulton se FSHZH nuk është autoritet publik sipas përkufizimit të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e Informimit".



TRANSPARENCA E AUTORITETEVE
PUBLIKE ËSHTË PARADHOMA
E MIRËQEVERISJES

VIZITONI WWW.IDP.AL

#informim #transparencë #vendim

Për sa i përket argumentit të parashtruar nga FSHZH, Komisioneri vlerëson se, ky argument nuk qëndron. Në pikën 1 të nenit 2 të LDI përcaktohet qartë se: "Autoritet publik" është (...) c) çdo person fizik ose juridik, të cilit i është dhënë me ligj, akt nënligjor ose çdo lloj forme tjetër, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, e drejta e ushtrimit të funksioneve publike".

Në kuptim të parashikimeve të mësipërme, FSHZH edhe pse gëzon statusin e organizatës jofitimprurëse, pavarësi drejtuese, administrative, financiare dhe teknike, është person juridik, i cili ushtron funksione publike dhe nuk përjashtohet si subjekt i ligjit nr. 119/2014. Për rrjedhojë, detyrohet për zbatimin e tij, duke garantuar njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës dhe llogaridhënies, për më tepër që informacioni dhe dokumentacioni i kërkuar, lidhet me mënyrën e menaxhimit të fondeve publike, mbështetur në pikën 2 të nenit 1 të ligjit nr. 19/2014 "Për të drejtën e Informimit".

Ndërkohë me anë të Vendimit nr. 42 datë 07. 10. 2020 Zyra e Komisionerit ka rrëzuar ankesën e qytetarit B. L ndaj Bankës OTP Albania Sh.a. KDIMDP pas shqyrtimit paraprak të ankesës dhe verifikimit të fakteve dhe bazës ligjore të saj, si dhe verifikimin e kryer në QKB rezulton se Banka OTP Albania Sh.a është një shoqëri tregtare, me aksione private, e zotëruar 100 % nga subjekt privat.

Në bazë të pikës 1 të nenit 2 të LDI Banka OTP Albania Sh.a nuk është autoritet publik, në kuptim të ligjit nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit". Për rrjedhojë, ankesa e paraqitur nuk i nënshtrohet dispozitave të këtij ligji, për të vijuar më tej procedurat për shqyrtimin e saj.

Për më shumë informacion mund të lexoni të plotë vendimin në faqen e KDIMDP www.idp.al.

**TË NJOHIM
KOORDINATORËT E TË
DREJTËS PËR INFORMIM**
MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Emër Mbiemër: Adenisa Ago

Funksioni: Juriste

Drejtoria: Drejtoria e Mirë Administrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve

Autoriteti Publik: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Data e emërimit si koordinator: tetor 2019

Eksperiencia të mëparshme si koordinator për të drejtën e informimit: Jo

Email: Adenisa.Ago@bujqesia.gov.al

Nr. telefonit: 042226551

Numri i kërkesave për informacion të regjistruar gjatë vitit 2020: 52 kërkesa për informacion

Si e vlerësoni nivelin e transparencës së autoritetit publik ku ju punoni? Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka publikuar në faqen zyrtare (në linkun: <https://bujqesia.gov.al/programi-i-transparences/>) programin e transparencës, në të cilin ka pasqyruar kategoritë e informacionit të detyrueshëm për t'u bërë publike në përputhje me nenin 7, të Ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit". Ministria përditëson programin e transparencës sa herë ka ndryshime në informacionet e pasqyruara në të. Gjithashtu, lidhur me kërkesat për informacion që janë dërguar, ministria ka informuar kërkuesin brenda afateve të përcaktuara në ligj nëse ka ose jo në zotërim informacionin e kërkuar. Në rastet kur ka rezultuar se zotëron informacionin e kërkuar, i ka mundësuar kërkuesit të drejtën për t'u njohur me informacionin publik. Ndërsa, në rastet kur ka rezultuar se nuk e zotëron informacionin e kërkuar, ia ka dërguar kërkesën për informim autoritetit publik përkatës, duke njoftuar edhe kërkuesin.

Cila është vështirësia më e madhe që hasni në detyrën tuaj si koordinatorë për të drejtën e informimit? Parimi i së drejtës për informim është një element shumë i rëndësishëm i shtetit të së drejtës. Për këtë arsye, personat e interesuar duhet të informohen nga autoritetet publike për informacionin që kërkojnë sipas kufijve të përcaktuar në ligj. Në praktikë dallimi i rasteve se kur kufizohet kjo e drejtë nuk ka qenë në çdo rast i lehtë, prandaj, kjo ka qenë edhe një nga vështirësitë që kam hasur në detyrën si koordinatorë për të drejtën e informimit. Një vështirësi tjetër që kam hasur lidhet me identifikimin e informacionit të kërkuar në rastet kur kërkesa ka qenë e paqartë.

Cili është sugjerimi juaj për përmirësim në zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit?

Për përmirësim në zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit, sugjeroj që koordinatori për të drejtën e informimit të gëzojë një status të veçantë në autoritetin publik në të cilin ai punon, në mënyrë që të ketë kohë dhe mbështetje të mjaftueshme në trajtimin e kërkesave për informacion.

E drejta e informimit, transparencë për mirëqeverisjen

Gjatë muajit tetor në Zyrën e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale u zhvillua një takim me koordinatore të Kryeministrit dhe ata të ministrive. Gjatë këtij bashkëbisedimi u diskutuan çështje rreth transparencës proaktive, zbatimin e rekomandimeve të Zyrës së Komisionerit për përditësimin e Programit të Transparencës së këtyre Autoriteteve Publike; përdorimin e “Regjistrit elektronik të kërkesave dhe përgjigjeve për të drejtën e informimit” (REKPMI) nëpërmjet portalit pyetshtetin.al si dhe për ankesat në proces dhe problematikat e hasura gjatë trajtimit të tyre. Roli i koordinatorit ishte një tjetër temë e diskutuar në takim, ku Zyra e Komisionerit do të vijojë asistencën dhe mbështetjen në forcimin e pozicionit të tyre në strukturat e Autoriteteve Publike.

